



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0568

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Grandelite” L.L.C. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni (kallderm) Rr. Pandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hoxh Kadri Prishtina” me numër të prokurimit VU644-24-3363-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrisë, me datë 07.08.2024 mori:

Vendim

Miratohet si e bazuar ankesa e OE “Grandelite” L.L.C. me nr. 2024/0568 e datës 28.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni (kallderm) Rr. Pandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hoxh Kadri Prishtina” me numër të prokurimit VU644-24-3363-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrisë.

Anullohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit kthehet në **rivlerësim**.

Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje

me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 04.04.2024 Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni (kallderm) Rr. Pandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hoxh Kadri Prishtina” me numër të prokurimit VU644-24-3363-5-2-1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar 170,504.55€ dhe me kriter të dhënies së kontratës – tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Me datë 18.06.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Gurëbardhi Sh.P.K. & AL Beton Sh.P.K.”. Me datë 29.06.2024, OE “Grandelite” L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 13.06.2024. Me datë 24.06.2024 operatori ekonomik ankues “Grandelite” L.L.C. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0568.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Grandelite” L.L.C. manifestohen duke kundërshtuar arsyen për eliminimin e ankuesit sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të formuluar nga AK si në vijim: *“mungon një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur me të cilën dëshmohet për makinerinë dhe pajisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet”*. Ankuesi konsideron se e ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur aneksin 7 të DT lidhur me makinerinë dhe pajisjet e kërkuara nga AK ashtu që aneksi 7 është pikërisht deklarata që e ka kërkuar AK përmes DT si dhe ka dëshmuar dëshmitë tjera përcjellëse për të konfirmuar pronësinë dhe posedimin mbi makinerinë dhe pajisjet e kërkuara nga AK.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 15.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “*Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore, shqyrtimit te terë dokumenatacionit te ofertës ne baze te Nenit 114 paragrafit 2 rekomandon PSH.OSHP qe te aprovoj ankesen e Gr OE-ve ankues si te bazuar dhe te thej proceduren ne Rivlerësim*”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore janë prezantuar si në vijim:

“Bazuar ne kërkesen e dosjes se tenderti operatori ekonomik ankues ka prezantuar komplet makinerit e kërkuara sipas aneksit nr.1 te dosjes se tenderti, ku ka bashkangjitur edhe dëshmit , DUD Doganor, Marrveshjet për shfrytësim, Fatura, Foto etj. Lidhur me pretendimin e eliminimit ne letren standarde se OE nuk ka dorzuar Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen dëshmohet për makinerin dhe paisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet, ne cilesin e eksperti shqyrtues konstatoj se OE ka dorzuar listen e pasijeve konform DT te cilen e ka nenshkruar dhe vulosur e cila ploteson Aneksin nr.7.

Duke pasur parasysh Neni 71 te LPP, Grandelite L.L.C & IoT Smart & Green SHPK dhe UDHA SHPK kan marrveshje bashkëpunimi për këtë projekt. Te gjitha makinerit e kerkuara nga ana e AK jane ne pronesi te operatoreve ekonomik sipas marrveshjes se bashkepunimit dhe kjo është një dëshmi dhe garancë dhe fakt shtesë se OE posedon makinerit e kërkuara sipas kërkesës se AK-së dhe pammishtë plotëson kriterin sipas kërkeses se DT dhe Nenii 69 te LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, interesi i AK dhe kerkeses se tyre është plotesimi i kerkeses per paisjet e kërkuara dhe këtë e ka ofruar dhe deshmiar GOE ankues, andaj për çdo paqartësi lidhur me paisjet e ofruara dhe konform LPP-së Nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, ka pasur mundesin qe te vërtetoj dhe konstatoj çdo pikë te tenderti apo kërkesë.

Ne cilesin e ekspetit shqyrtues konstatoj dhe vërtetoj se ne baze te dokumentacioneve te ofruara dhe prezantuara nga ana e GOE ankues, te njejtit plotësojn kriterin e kërkuar sipas Aneksit nr.7 për pasijet , te njetit kan vulosur dhe nenshkruara edhe Aneksin nr.7 sipas kerkeses se AK , poa ashtu kan ofruar te gjitha deshmit mbi pronesin e paisjeve, bazuar ne te gjitha këto mos ofrimi i nje deklarate me shkrim për makinerit ne dispozicion kosideroj se është vetem nje defijom i vogel qe nuk mundet te shkaktoj ndryshim material ose devijim nga ajo karakteristikat e tenderti pasi qe OE kan ofruar deshmit për pronesi te makinerive qe është me bindese se sa deklarata ne këtë rastë.

Ne baze te Nenit 59 te LPP-së paragrafit 4 pikës (ii) konstatoj se mos ofrimi i deklarates me shkrim , (ii)përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktjnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

*Eksperti shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese jane te obliguara qe te sigurojn qe fondet publike dhe burimet publike te përdorën në mënyrë më ekonomike njëkohësishtë duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashuhët në Nenin 6 te LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë ne konsideratë edhe Nenin 1 te LPP-së pasi që dihet se qëllimi i këti ligji është te siguroj mënyrën më efikase, me transparente, jo diskriminuese dhe me te drejtë të shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve ne mënyr të duhur dhe ligjore. **Duke pasur parasysh pretendimin ankimore dhe shqyrtimin e dokumentacioneve dhe shtjellimit si me lartë konstatoj se pretendimi ankimore është i bazuar”.***

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të mbështetura edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet e OE ankues janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se arsyeja për eliminimin e ankuesit nga AK është formuluar si në vijim: *“mungon një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur me të cilën dëshmohet për makinerinë dhe pajisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet”*. Përtej elaborimeve të detajuara të ekspertit shqyrtues të cituara si më sipër, me të cilat Paneli Shqyrtues pajtohet në tërësi, duhet shtuar faktin se arsyeja për eliminimin e ankuesit nuk përbën kusht administrativ. Prandaj AK me rastin e rivlerësimit mund të kërkoj sqarime shtesë nga ankuesi lidhur me këtë deklaratë me qëllimin që të konfirmoj se ankuesi i posedon të gjitha pajisjet e kërkuara përmes DT. Në anën tjetër fakti që ankuesi e ka nënshkruar dhe vulosur aneksin 7 të DT nuk është aspak kontestues për AK. Ngjashëm nuk është kontestues as fakti që ankuesi ka dorëzuar edhe dëshmi tjera të mjaftueshme që ankuesi është pronar dhe posedues i pajisjeve/makinerive të kërkuara me DT. Në këtë drejtim AK duhet të bëj përpjekje maksimale që të kursej buxhetin publik të AK në përputhje me nenin 1, nenin 6 dhe nenin 7 të LPP. Në rastin konkret tenderuesi i rekomanduar nga AK është rreth 9.5% apo mbi 15 mijë euro më i shtrenjtë sesa ankuesi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë të datës 18.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni (kallderm) Rr. Pandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hoxh Kadri Prishtina” me numër të prokurimit VU644-24-3363-5-2-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën

OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Grandelite L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: